VENDIM
Nr. 684, datë 23.10.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400 kV FIER"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i nënstacionit 400 kV Fier".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme 12 850 972 (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 12 850 972 (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh, do të përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim në zyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.
8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST), sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të OST sh.a.
9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Fier të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale.
10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË PROJEKTIT "NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400 kV FIER"

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: "Tokë arë"

Nr.	Të dhëna për pronësinë							Sip. e shpronësuar m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera e shpronësimit në lekë	Vlera kulturave bujqësore	Vlera totale e shpronësimt në lekë	Shënime.
	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sip. totale e pronës m^2						
Bashkia Fier													
Drizë	**Zona kadastrale nr. 1557**												
1	Shaban	Sihat	Gjeli	arë	1557	190/1	2,218	2,218	269	596,642	30,800	627,442	Konfirmuar nga ZVRPP Fier, Kufizim pronësie
2	Iljaz	Nurce	Shateri	arë	1557	192/1	878	878	269	236,182	12,250	248,432	Pa certifikatë pronësie
3	Nuredin	Iljaz	Shateri	arë	1557	192/2	437	437	269	117,553	6,300	123,853	Pa certifikatë pronësie
4	Fatmir	Xhemil	Brakaj	arë	1557	250/7	4,557	4,557	269	1,225,833	63,700	1,289,533	Me certifikatë pronësie
5	Ymer	Dine	Muhameti	arë	1557	250/8	4,187	4,187	269	1,126,303	230,050	1,356,353	Pa certifikatë pronësie
6	Ismail	Muhamet	Muhameti	arë	1557	250/9	4,125	4,125	269	1,109,625	57,750	1,167,375	Pa certifikatë pronësie
7	Fetah	Rrapush	Hoxha	arë	1557	250/10	2,312	2,312	269	621,928	401,100	1,023,028	Pa certifikatë pronësie
8	Ali	Kodhel	Myrto	arë	1557	250/12	406	406	269	109,214	5,600	114,814	Pa certifikatë pronësie
9	Zyni	Ali	Myrto	arë	1557	250/13	2,093	2,093	269	563,017	754,450	1,317,467	Pa certifikatë pronësie
10	Shpresa	Rrapo	Myrto	arë	1557	250/14	1,937	1,937	269	521,053	633,750	1,154,803	Pa certifikatë pronësie
11	Xhevair	Ali	Myrtaj	arë	1557	250/15	1,625	1,625	269	437,125	285,200	722,325	Me certifikatë pronësie
12	Luan	Idai	Gjata	arë	1557	250/16	562	562	269	151,178	5,950	157,128	Pa certifikatë pronësie
13	Agron	Idai	Gjata	arë	1557	250/17	875	875	269	235,375	9,100	244,475	Pa certifikatë pronësie
14	Kostandin	Vangjel	Saramanda	arë	1557	250/18	1,078	1,078	269	289,982	15,400	305,382	Me certifikatë pronësie
15	Zoi	Vangjel	Saramanda	arë	1557	250/19	1,078	1,078	269	289,982	15,400	305,382	Me certifikatë pronësie
16	Bani	Llazi	Bare	arë	1557	250/20	1,000	1,000	269	269,000	14,000	283,000	Me certifikatë pronësie
17	Filip	Tezho	Bare	arë	1557	250/22	1,000	1,000	269	269,000	14,000	283,000	Pa certifikatë pronësie
18	Mihal	Tezho	Bare	arë	1557	250/23	1,000	1,000	269	269,000	14,000	283,000	Pa certifikatë pronësie
19	Nikollaq	Todi	Bare	arë	1557	250/25	1,776	1,776	269	477,744	23,800	501,544	Me certifikatë pronësie
20	Feti	Meto	Gjata	arë	1557	250/26	974	974	269	262,006	13,650	275,656	Pa certifikatë pronësie
21	Flutura	Feti	Gjata	arë	1557	250/27	187	187	269	50,303	2,800	53,103	Pa certifikatë pronësie
22	Ismet	Feti	Gjata	arë	1557	250/28	1,278	1,278	269	343,782	17,850	361,632	Me certifikatë pronësie
23	Mihal	Taqi	Bare	arë	1557	250/29	1,407	1,407	269	378,483	19,600	398,083	Pa certifikatë pronësie
24	Dhoksi	Llazi	Bare	arë	1557	250/30	898	898	269	241,562	12,600	254,162	Me certifikatë pronësie
Sipërfaqe totale shpronësimi m^2								**37,888**					
Vlera totale e shpronësimt në lekë për sipërfaqet e pronësisë										**10,191,872**			
Vlera e shpronësimt në lekë për kulturat bujqësore											**2,659,100**		
Vlera totale e shpronësimt në lekë												**12,850,972**	